



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 13/2015

Prishtinë, më 01.4.2015, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Visar Ymeri, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca, Pal Lekaj, Enver Hoti dhe Duda Balje- anëtarë.

Munguan: Sasha Milosavleviq dhe Fatmir Rexhepi - anëtarë.

Pjesëmarrëse e ftuar : znj. Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Rexhep Bllaca-MTI; Petrit Hysaj-OSBE; Dardan Abazi – INDEP; Zhivojin Qirkoviq – Gior; Besa Berisha dhe Arta Xhylani – UNDP (praktikante).

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetari i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.03.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja;
4. Nisma legjislative për hartimin e Projektligjit për sigurinë në punë në miniera, e propozuar nga deputetja Sala Berisha - Shala;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.3.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.3.2015, u miratua më këtë plotësim nga anëtarët i Komisionit, z. Raif Qela, i cili tha se duhet në pikën e tretë të rendit të ditës të shtohet ky tekst: *Raif Qela - tha se amendamenti 8 duhet të riformulohet në aspektin përmbajtësor. Jam njëri prej atyre që kam qenë krejtësisht i pakënaqur me mënyrën e deritashme të privatizimeve, tha ai. Rezultatet e këtyre privatizimeve flasin. Sidomos kur kemi të bëjmë me çështjet më rëndësi nacionale, është mirë që të kemi konsensus politik. Duhet të kemi një minimum të konsensusit politik edhe në rastin e privatizimit të ndërmarrjeve. Por edhe kriteri 2/3 e votave të anëtarëve të Kuvendit, i domosdoshëm për privatizim të ndërmarrjeve, i cekur në Amendamentin 8, është i lartë dhe duhet të zbutet, sepse si i tillë nuk do të kalojë në votim. Meqenëse teksti i amendamentit 8, si i tillë çfarë është propozuar, konsideron se nuk është formuluar qartë, propozoi që ai të riformulohet edhe një herë para se të dërgohet në seance plenare, ashtu që të jetë si vijon: “9.2 aksione të ndërmarrjeve nga neni 11.3 të këtij Ligji mund të tjetërsohen vetëm pasi që vendimi i miratuar i Qeverisë të jetë votuar nga Kuvendi i Kosovës me 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit”.*

3. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, -Tha se pasi që në bazë të Planit të punës të Komisionit e kemi vendosur që të mbikëqyrim ligjin për investimet e huaja. Ne e kemi informuar Komisionin në përbërje të z. Besim Beqaj, kryesues, z. Blerim Grainca, z. Pal Lekaj dhe znj. Duda Balje, që ta bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. Ne e kemi marrë raportin e Komisionit ku shihet, se Komisioni, apo grupi punues, ka bërë një aktivitet domethënës dhe na ka sjellë disa materiale që i kemi sot këtu, por sot e kemi ftuar ministren që të kontribuojë në pasurimin e këtij raporti në mënyrë që kur të shkojë në Kuvend të jetë sa ma i plotë. Pastaj, ia dha fjalën z. Besim Beqaj që të bëjë një arsyetim të raportit dhe mandej të hapet diskutimi.

Besim Beqaj- Tha se konform vendimit që ne, në Komision, kemi marrë për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për investimet e huaja. Ne kemi filluar punën fillimisht duke kërkuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht Departamenti Ligjor dhe KIESA si agjencia për promovim të investimeve dhe mbështetje të ndërmarrjeve, që të na bëjë një raportim me shkrim, i cili do duhej që t' na jepte pasqyrën e harmonisë ligjore që ka ky ligj me ligjet e tjera, pastaj kemi pasur takimet me dy këto institucione, ndaras për ta kuptuar a ka ndonjë kolizion ligjor ligji aktual respektivisht të cilat janë veprimet e KIESA-s dhe çka ka identifikua KIESA, apo ndonjë nevojë që duhet të trajtohet në kuadër të rekomandimeve, respektivisht hapave që do të merren. Përpos këtyre takimeve në plan kemi paraparë që të kemi takime edhe komunitetin e biznesit, asociacionet e biznesit jemi takuar me të gjitha asociacionet e biznesit përfshirë këtu AKB-në, Odën Ekonomike të Kosovës, Odën Ekonomike Amerikane, Odën Ekonomike të Austrisë, dhe gjithashtu edhe me investitorët të cilët ata i kanë sjellë nëpër takime. Kemi vizituar KIESA-në në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ku ka qenë edhe zëvendësministri z. Avni Kastrati. Dhe, pastaj kemi bërë edhe debat publik, pra dëgjimin publik, ku kanë marrë pjesë asociacione civile, biznese, shoqëria civile disa ndërmarrës që janë ftuar nga Odat Ekonomike etj. Parimisht konsiderohet që ligji si i tillë nuk ka ndonjë problem si tërësi, është ligj i cili mbulon relativisht mirë fushën e tij, por që problem është gjetur gjatë tërë komunikim me bizneset mekanizmat e tjerë kanë qenë emri i ligjit, sepse është konsideruar nga komuniteti i biznesit dhe nga

asociacionet në një farë forme tregon si favorizues për investitorët e jashtëm. Unë, si deputet, kam kërkuar nga njësia përgjegjëse në Kuvend që ta bëjë një hulumtim lidhur me emërtimin dhe që realisht pak dallon nga ajo që na është thënë nga Ministria, sepse vetë vendet e rajonit kanë ligje për investime të huaja, ndërsa Kroacia, Sllovenia dhe vendet e tjera nuk kanë ligj të veçantë për investimet e huaja, por kanë ligj për promovime, ligj për tërheqjen e investimeve gjë që nuk qëndron që gjitha vendet e rajonit është praktikë ndërkombëtare. E gjetur tjetër është ligji nuk përmbush kërkesat e investitorëve për mbrojtje dhe përkrahjet e investitorëve, aty parashihet me ligj mbrojtja dhe përkrahja, por që është në mënyrë shumë të gjeneralizuar, realisht nuk ka hapa konkret. Besojmë të gjithë që si e gjetur ka nevojë të fuqizohet KIESA, si agjenci, dua të them shumë hapur që është relativisht dobët e organizuar pa ndonjë strukturë të qartë, pa staf i cili është stabil, do më thënë drejtori është me ushtrues detyre, nuk kanë lista të qarta të investitorëve potencialë të cilët janë apo kanë kërkuar nuk e kanë regjistrin e investitorëve të cilën është dashur ta bëjnë. Pastaj ka qenë një udhëzim administrativ i cili është dashur të nxjerrët, udhëzimi është nxjerrë, por që besojmë konform komisionit dhe komunikimit që kemi pasur me pjesën tonë ligjore se që ky edhe njëherë të shikohet a është në harmoni të plotë me frymën e ligjit dhe dispozitat e parapara? Ne, një nder pyetjet që e kemi diskutuar ka qenë, a keni pasur raste kur keni asistuar, sepse ka pasur raste kur është paraqitur problem marrja e lejes se punës për njerëzit të cilët është dashur të shkonit nëpërmjet mekanizmit të Ministrisë së Punës Brendshme në Departamentin i cili është përgjegjës për to dhe ka pasur raste të tilla. Sa i përket pjesës dhe zbatimit është kjo çështje, por gjatë komunikimit me biznesin ne kemi vërejtur që ka shumë gjëra që nuk ndërlidhen në mënyrë drejtpërdrejtë me këtë ligj, por me gjëra të tjera. Është konsideruar që problem kryesor është sundimi i rendit dhe ligjit, burokracia korrupsioni, informaliteti, gjëra që e pengojnë nga këndvështrimi i brendshëm investimet që duhet t'i bëjnë. Pastaj politikat fiskale, është kërkuar që të hiqet TVSH për lëndë të parë, rimbursimi të TVSH- së, me një fjalë që është kërkuar nga komuniteti i biznesit që vendimi për lirin për pushime nga taksat i cili është marrë nga viti i kaluar nga Qeveria të zyrëtarizohet, sepse konsiderohet se është në urgjencë të nivelit maksimal. Në fund i prezantoj Rekomandimet e grupit të punës si vijon:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës ta ndryshojë Programin Legjislativ për vitin 2015 dhe ta përfshijë ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për investimet e huaja, ku përveç tjerash të përfshijë:
 - Në emërtimin e ri të ligjit të mos jetë fjala “e huaj/a” në mënyrë që mos të aludohet se po i referohen vetëm investimeve të huaja;
 - KIESA të zhvendoset në Zyrën e Kryeministrit nga MTI-ja;
 - KIESA të këtë autorizim ligjor që në emër të investitorëve t'i kryejë të gjitha procedurat për nxjerrjen e lejeve dhe licencave në mënyrë që t'ju krijohet një ambient sa më i lehtë dhe i favorshëm për investime të huaja;
 - Qeveria e Republikës së Kosovës, që me vendim të veçantë në rast të investimeve strategjike, investimeve me vlera të mëdha, si dhe investime të cilat punësojnë numër të madh të punëtorëve që të ketë të drejtë t'ia japë tokën në shfrytëzim investitorit të huaj në harmoni me legjislacionin në fuqi.
2. Në mënyrë që të mundësohen investimet strategjike, kërkohet nga Qeveria që të rishikojë legjislacionin më qëllim negocimin e drejtpërdrejtë me investitorët për sektor të veçantë;
3. Qeveria të jetësojë Vendimin Nr. 04/186 të datës 29.04.2014 për pushimin e taksave për një periudhë të caktuar;
4. MTI përkatësisht KIESA të krijojë data bazë me informacione të bollshme për investitorë, të themelojë Regjistrin e investitorëve të huaj, të mbështesë krijimin dhe zhvillimin e mjedisit të përshtatshëm për NMVM-të, të krijojë kapacitete dhe të ofrojë përkrahje bizneseve edhe pas realizimit të investimeve;

5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Punëve të Brendshme të shtojnë efikasitetin në dhënien e lejeve të punës, përkatësisht të qëndrimit për punonjësit e huaj;
6. Kërkohet nga institucionet përgjegjëse që të mundësojnë zbatueshmërinë e kontratave dhe mbrojtjen ligjore të investitorëve;
7. Institucionet publike në tërë procesin e hartimit të legjislacionit t'i ofrojnë hapësirë organizatave të biznesit dhe odave ekonomike vendore dhe të huaja, për të dhënë rekomandimet e tyre;
8. KIESA së bashku me odat ekonomike vendore dhe të huaja të bëjnë promovimin e gjykatës së arbitrazhit e cila vepron në Kosovë;
9. MTI në afat prej tremujsh pas miratimit të këtyre Rekomandimeve të zgjedhë drejtorin e Përgjithshëm të KIESA-së;
10. KIESA kërkohet të përmirësojë performancën e saj në përkrahje të investimeve dhe të rrisë bashkëpunimin me komunitetin e biznesit;
11. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të monitorojë zgjedhjen dhe emërimin e nëpunësve civilë në KIESA dhe t'i dorëzojë Komisionit një Raport lidhur me këtë çështje në afat prej tre muajsh pas miratimit të këtyre Rekomandimeve;
12. Zyra e Rregullatorit të Energjisë dhe institucionet përkatëse të rishikojnë kushtet e furnizimit me energji dhe të njoftojnë ndërmarrjet apo bizneset për intervenimet në rrjet edhe ndërprerjen e paplanifikuar të energjisë elektrike, së paku 24 orë para ndërprerjes.

Pal Lekaj: Pajtohem me gjithë atë që tha kryesuesi i grupit punues sa përket të gjeturave dhe rekomandimeve. Ajo që më shqetëson mua është agjencia KIESA që me të vërtetë gjendja është kaotike, njerëzit janë rekrutuar në shpërfillje me ligjin mbi shërbimin civil, nga ish -drejtori Valdrin Lluka, sekretarja permanente dhe tjerët që pothuaj nuk e kanë përfillur fare ligjin mbi shërbimin civil dhe ligjin për investimet e huaja sa i përket profesionalizmit. Sepse aty në vend të zyrtareve kompetent janë vendosur zyrtarë grafik dizajn, juristë etj. Në fund kërkoj miratimin e rekomandimeve të grupit të punës dhe kërkoj nga ministrja që urgjentisht të ndryshojë gjendjen të fillojë konkursi dhe të përfillen kriteret për punësim, njerëzit që duhet me qenë në këtë agjenci.

Blerim Grainca Tha se grupi i punës ka punuar me hapa të shpejtë dhe të fuqishëm, ju keni marrë raportin e konstatimit me të gjeturat nga gjithë dhe kjo po rezulton se kemi dy grupe të problemeve: ambientin e jashtëm të bëhet biznes që reflekton në krejt situatën e përgjithshme në Kosovë, ku janë problemet me sundimin e ligjit apo funksionimin e gjykatave dhe, pjesa tjetër e problemeve që janë më tepër të karakterit organizativ dhe që merren me menaxhimin ditor të shërbimeve që ofron ministria. Në raport nuk e keni shënuar por mendoj që edhe ne, si Komision, që ta rishikojmë dhe ta bëjmë si konstatim të mundshëm se këto janë problemet që janë grumbulluar ndër vite, problem që disa janë të trashëguara disa janë si rezultat i kohës, disa si rezultat i menaxhimit të problemeve që ka ndodhur në ministri. Mendoj që ky raport do t'i shërbejë edhe ministres edhe neve, në mënyrë që të punojmë bashkërisht për ndryshimin e situatës në të cilën jemi dhe normalisht theks i veçantë do duhej që ky raport t'i kushtohet edhe situatës që mbretëronte te KIESA në konstatimin që e thashë se janë probleme të trashëguara dhe nuk janë të ditëve të fundit.

Duda Balje- Tha që duhet t'i dimë arsyet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë se ku është problemi, pse nuk po vijnë investitorët e huaj me investuar në Kosovë? Kërkoj që Ministria Tregtisë dhe Industrisë, së bashku me Qeverinë, duhet të gjejnë zgjidhje urgjente për t'i sjellë investitorët huaja në vend përmes politikave dhe programeve të avancuara sikurse në vendet e tjera.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë – Tha se e kemi lexuar raportin dhe kemi qenë të informuar edhe nga stafi i ministrisë për takimet që i keni pasur. Është një gjendje

të cilën e kam trashëguar dhe nuk është aspak e lehtë, gjendja është tepër e komplikuar dhe po mundohemi të gjejmë një rrugë ligjor për ta zgjidhur, sepse siç e dini, ne me ligj, ministrat e kemi të kufizuar që t' i fusim duart në shërbimin civil. Mirëpo kur shërbyesit civilë do të vijnë ne Kuvend të ankohen, ne patjetër do të na detyrojnë që të marrim masa. Sa i përket gjendjes së investimeve të huaja dhe zbatimit të ligjit në përgjithësi edhe ne nuk jemi të kënaqur qysh nga ditët e para kemi mbajtur workshop me të gjitha departamentet dhe gjithashtu me agjenci për promovim të investimeve dhe mbështetje të ndërmarrjeve në Kosovë që është KIESA dhe pas një muaji që kemi filluar punën ka dhënë dorëheqje drejtori që ka qenë, z. Valdrin Lluka, i cili në fakt nuk ka pasur kurrfarë presioni. Procedurat për shpalljen e konkursit pothuajse janë në përfundim, janë duke u zhvilluar, dhe është Ministria e Administratës Publike, ajo e cila po bën zgjedhjen e një kryeshefi. Unë i pashë edhe të gjeturat të cilat janë pengesat kryesore të investitorëve të huaj dhe u përmend këtu rendi dhe ligji, korrupsioni i lartë, do të thotë mbrojtja mos ekzekutimi i kontratave, pritja e gjatë e investitorëve të huaj, por edhe të atyre vendore nëpër gjykata për t' i zgjidhur kontestet e tyre që i kanë dhe të gjitha ato kanë kontribuar në një trend negativ që i kemi viteve e fundit, imazhi jo i mirë për Kosovën etj. Sa i përket emërimit të ligjit ne kemi pasur vërejte edhe më herët se është konsideruar që po favorizohen investitorët e huaj e që na nuk i kemi masat e tilla për investitorët e tjerë. Mirëpo ne e kemi vërejtur që faktikisht kjo nuk qëndron, po që bashkërisht vendosim që ta plotësojmë dhe ndryshojmë ligjin atëherë ne mundemi ta bëjmë një gjë të tillë. Faktikisht ky është një ligj i cili ka të bëjë me shumë me mbrojtjen e investimeve, se sa me ofrimin e pakove të tjera, të cilat i kemi diskutuar këtu edhe ne qysh në ditët e para e kemi bërë një skanim të gjendjes së rajonit, sepse jemi në konkurrencë të drejtpërdrejtë me vendet e rajonit. Ndërsa pakot e tjera vendet fqinje i kanë të ofruara me ligjet e tjera p.sh. pakoja fiskale e cila tash ka kaluar mendojmë që është një pako mjaft atraktive dhe ato pushimet kohore që i keni rekomanduar janë futur në ligjin për të ardhurat e korporatave, të hyrat nga korporata në ligjin për TVSH-ën, e dini që është bërë lirimi i makinerisë. Po punohet shumë në bashkëpunim me Ministrin e Financave, që faktikisht këto barrierat të adresohen atje, që ka një plan se si do të ndahen detyrat dhe përgjegjësit e të gjithë inspektorëve, qoftë të doganës, qoftë të administratës tatimore, dhe mendoj që fuzionimi i këtyre dy institucioneve në një masë të madhe do të ulë burokracinë dhe do e rris transparencën e këtyre institucioneve, e cila kish me kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e ambientit të biznesit. Sa i përket KIESA-s, ju e dini që me plotësim ndryshimin e ligjit ndryshimi i fundit që është bërë aty është bërë fuzionimi i dy agjencive, pra agjencia për mbështetje të ndërmarrjeve dhe agjencia për promovim të investimeve në një. Ajo që në fakt na ka befasuar është fuzionimi i këtyre dy agjencive ka lënë një pjesë të stafit tepriçë, ndërkohë që tash i kemi të dy agjenci, si dy departamente. Sa i përket rekomandimit që KIESA të zhvendoset në zyrën e Kryeministrit prej Ministrisë, ne nuk kemi asnjë kundërshtim, mirëpo duhet të kemi parasysh nëse KIESA me kapacitetet ekzistuese e zhvendosim në zyrën e Kryeministrit nuk është që nuk bëjmë zgjedhje të problemit. Ne, si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë, shumë shpejt do e riaktivizojmë Këshillin Kombëtar për zhvillimin ekonomik, aty kemi marr rolin e koordinatorit dhe sekretariati i këshillit do të jetë në kuadër të ministrisë. Ndërsa sa i përket asaj se sa do të bëhet autorizim ligjor KIESA për t' i kryer të gjitha ato procedurat administrative regjistrimin dhe marrjen e lejeve ne mendojmë që ka implikime të mëdha buxhetore, duhet të shtohet numri i stafit etj.

Enver Hoti- Tha se në dëgjimin publik në prezantimin që e ka bërë KIESA lidhur me klimën për investimet e huaja nuk ka qenë e arsyeshme dhe nuk ka shfaqur ndonjë potencial sado që kanë punuar në drejtim. Ne i kemi dhënë edhe vërejtjet tona dhe kjo që është bërë me këto rekomandime e mbështes, por edhe ministren e mbështes që KIESA të mos bartët në zyrën e Kryeministrit, por të mbetet aty si agjenci dhe natyrisht kisha ngritur një problem që është shumë shqetësues që është problem i agjencive me përgjegjësi në vend, dhe nuk e kam shumë të qartë, pse departamentet përkatëse që kanë fushat brenda ministrive krijojnë agjenci? Unë kam një vërejtje të madhe të agjencitë, po sigurisht do ta trajtojmë edhe herëve të tjera, si problem i tillë

që këto janë shndërruar më shumë në një komponentë politike të caktuara dhe të cilat po bëhen pengesë e zhvillimit të vendit.

Besim Beqaj – Tha se nëse flasim për emërtimin e ligjit, i ka dy- tri qartësime, sepse ky ligj është mbizotërues mbi ligjet e tjera në rastin e investimeve të huaja dhe që realisht kjo është pengesa kryesore që shihet nga komuniteti i biznesit. Besoj se do të ishte shumë ma e logjikshme që të thuhet ligj për investime ose ligj për mbrojtje të investimeve, por jo do të thotë vetëm si investime të huaja! Pra qëndroni në racionalitet jo vetëm te emri. Sa i përket zhvendosjes në Zyrën e Kryeministrit kjo ka qenë ide edhe e më hershme edhe unë besoj se bëhet fuqizimi i saj sepse nuk bëjmë implantime, ngase implantime është bërë kur janë bërë të dyja bashkë, dy agjencitë. Sa i përket autorizimeve ligjore kjo ka qenë kërkesë e KIESA-s, dhe ne e kemi kundërshtuar, dhe e kemi zbutur rekomandimin tonë, sepse është konflikt interesi nëse dikush merr të drejtën në emër të dikujt dhe në llogari të dikujt! Kërkesa ka qenë në emër dhe në llogari. "ONE STOP SHOP" është e paraparë me ju dhënë informata të kompletuara investitorëve, çka mendoj është dashur kështu të jetë. Ne kemi thënë se a ka bërë KIESA, respektivisht ministria një analizë se çka ofron Maqedonia më shumë se sa Ne? Cilat janë kontaktet që keni bërë me bizneset, nëse kjo është krejt false si propagandë, cilat janë hapat e KIESA-s, respektivisht të ministrisë me i kundërshtuar këta, sepse ne nuk mundemi me qëndruar si spektatorë? Kërkojmë që Këshilli për Zhvillim Ekonomik të funksionalizohet sa më shpejt, është një mekanizëm që ka funksionuar dhe duhet të funksionojë dhe është e rregulluar, sekretariati ka qenë gjithmonë pjesë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Raif Qela- Tha se ky raport është i gjithanshëm, i ka shtruar problemet kryesore që kanë të bëjnë me investimet në përgjithësi dhe problemet e adresuara mendoj se janë paraqitur mirë. Mendoj se ky raport ka mundësi të sistematizohet më mirë, por se problemet kryesore i ka trajtuar drejt. Fjala e ministres ishte vetëm plotësim i konstatimit të raportit të grupit punues, respektivisht Komisionit dhe i dha disa detaje shumë të rëndësishme të cilat vetëm mund të bashkëngjiten kësaj pasqyre të raportit. Propozoj që emërtimi i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik në bazë të emrit për shumicën e atyre që e konsiderojnë komb, jo vetëm pjesën e shqiptarëve të Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës, jep të nënkuptohet se ky është Këshill Kombëtar është i formuar për të gjitha rajonet ku jetojnë shqiptaret dhe për këtë ka më shumë të drejtë të quhet Këshilli Shtetëror për Zhvillim Ekonomik edhe pse unë do të kisha dëshirë që ky Këshill Kombëtar të formohet në frymën e integriteteve kombëtare që po ndodhin.

Hykmete Bajrami, ministre e Tregtisë dhe Industrisë – Lëvizjen për agjenci për promovim të investimeve në Zyrën e Kryeministrit unë thashë se nuk e kundërshtoj aspak, po kjo duhet të bisedohet me ministrin e Financave dhe të shihet se sa mund të rriten kapacitetet. Në raportin financiar të Qeverisë thuhet se i kemi 165 milionë borxhe të trashëguara të vitit 2014 dhe është pak problematike me i rritur kapacitetet e agjencive kur kemi trashëguar borxhe të tilla. Ne kemi marrë informata se çka po ofrojnë vendet e rajonit dhe në Maqedoni p.sh., i kanë 70 veta staf të agjencisë për promovim të investimeve të cilët permanent janë duke qëndruar në vendet e tjera. Tash ne nuk mundemi me u krahasuar, imagjinoni kanë kapacitet të tillë financiar dhe ne nuk kemi ende edhe sot e kësaj dite atashe për ekonomi në ambasadat tona.

Visar Ymeri- Tha se këtu që po e diskutojmë një çështje që është mjaft e rëndësishme dhe që del edhe përtej këtij ligji që u përmend edhe me herët. Kur është puna për investimet a po vijnë, pse po vijnë, kur po vijnë, mendoj që kjo del përtej çështjeve që e diskutuam deri më tani dhe mendoj se pak si tepër u ndalem te kjo agjenci KIESA e cila e ka një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në strukturën institucionale të Kosovës, po nuk mund të themi që krejt problemet që i kemi me investimet rrjedhin si pasojë e KIESA-s. Në fakt kemi problem me krejt Qeverinë dhe me punën e saj, dhe në këtë drejtim nuk mendoj se mund ta ndajmë këtë ose si fajtor ose si diçka që është jashtëzakonisht e ndryshme prej aparatit tjetër shtetëror. Ministrja i përmendi disa

vendime të qeverisë të cilat i kanë marrë edhe me qëllim për t'i rritur investimet si pushimet nga tatimet, ndryshimet në TVHS, ndryshimet në procedurat e mbledhjes së TVSH-së, e kështu me radhë, që natyrisht mund të konsiderohen si mjete mekanizma që do ta ndihmonin investimin, po nuk e di a do të jenë të mjaftueshme dhe në këtë drejtim mendoj që këto mund të jenë mekanizma të mirë të cilët prapë do të rezultojnë në një situatë apo diçka që nuk është më e ndryshme e asaj që e kemi pa deri më sot. Të mos harrojmë se Kosova e ka bërë një ulje drastike të tatimeve të vitit 2008, nëse nuk gabojmë kur ka ardhur për herë të parë Partia Demokratike e Kosovës në pushtet me synimin për të rritur investimet në përgjithësi, por nuk kanë prodhuar ndonjë situatë e cila na ka ndihmuar shumë ekonomikisht. Pra dua të them që vetëm politika fiskale e pa përcjellë edhe me ndryshime të tjera nuk është se krijon çudira në investime. Pra si ministri, mendoj që deri tash do të duhet që ta kishit një ide të paktën se ku do ishin ata sektorë të zhvillimit dhe pastaj të kërkohej investimet në ata sektor, sepse investimet strategjike janë pikërisht për këta sektorë, por ti si shtet edhe e ke vendosur që mund t'i zhvillosh, do t'i zhvillosh dhe pastaj në të cilën do jenë edhe mekanizma ndihmues të tjerë për ta përkrahur këtë investim. U përmend edhe një problem që mendoj që është mjaft i rëndësishëm! Pra qasja në kapital i cili shpeshherë nga biznesi artikullohet si problem me kreditë me interesin e lartë të bankave dhe, qasja në kapital është me të vërtetë një problem që duhet të adresohet. Në fjalën e ministrit deri më tani nuk dëgjova se ka ndonjë plan të Qeverisë, ose që mendon Qeveria që do ta adresojë çështjen e qasjes në kapital. Sa i përket KIESA-s një prej arsyetimeve që unë mendoj se do të ishte mirë që ta kemi te Zyra e Kryeministrit për të ia shtuar peshën politike është që kjo agjenci si e kuptova do të duhej ta kishte përgjegjësin e bashkërendimit të punëve të ministrive të tjera që kanë të bëjnë me investime. Pra, të bashkëveprojnë këto veprime të ministrive apo departamenteve të veçanta në aparatet shtetëror në mënyrë që ta krijojnë një hapësirë më të lehtë për investime në Kosovë.

Sala Berisha Shala – Vlen të përshëndetet grupi punues në krye me zotin Beqaj për punën e mirë që ka bërë në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Dihet se ekziston një perceptim se në Kosovë nuk ka ambient për të investuar. Natyrisht që monitorimi sesa po zbatohen ligjet e ka edhe një qëllim tjetër kur vëren se diçka nuk po funksionon dhe pastaj për të pas një bazë një element për t'i hyrë plotësim ndryshimit të atij ligji. Të gjithë dëshirojmë që në Kosovë të ketë sa ma shumë investime. Ishte shumë interesant përshtypja e ministres, apo referimi i ministres dhe të gjeturat e grupit punues për monitorimin e këtij ligji shpesh nuk kanë qenë në të njëjtën valë. Me të drejtë e tha edhe kryesuesi i grupit punues se në KIESA nuk kemi gjetur ndonjë regjistër apo listim të problemeve që ata hasin. Investitorët e huaj nuk i gjejnë të dhënat e duhura ndërkohë që ministrja tha që ne kemi informacionin se investitorët e huaj shpesh janë ankuar në ministri se ka pas zvarritje të lejeve dhe licencave dhe mendoj që nuk ka qenë bash ashtu. Kjo na jep me treguar se institucionet mes vete duhet të punojnë bashkërisht, sepse është edhe obligim ligjor. Me sa di unë ligji për miniera dhe minerale i jep obligim ligjor Komisionit për miniera dhe minerale të bashkëpunojë me ministrinë tuaj, ka qenë e paraparë që të ketë një One stop shop me vendqëndrim në MTI. Sa i përket mungesës së theksuar të investimeve të huaja në Kosovë, ne duhet ta shohim nga një spektër pak më i gjerë se a ndikojnë faktorë të brendshëm apo edhe faktorë të jashtëm, dhe mendoj që me një angazhim bashkërisht dhe maksimal do të arrijmë ta zbusim këtë hendikep të madh që ballafaqohet Kosova me mungesën e investimeve të huaja.

Kryetari Muhamet Mustafa- Tha se ministrja ka konstatuar që janë problemet të caktuara dhe ajo ka filluar të zgjedhë dhe ne presim t'i zgjedhë sa ma shpejt. Kjo është çështja rreth organizimit të brendshëm, por ajo që unë dëshiroj të theksoj është që edhe Komisioni ka konstatuar që nuk është problemi te ligji, nuk është problemi te përmbajtja e ligjit. Unë kam pasur vërejtje për arsye se kur është aprovuar ligji rreth emërimit i kam thënë disa mendime të mia, por po shihen se edhe ato do të shihen ma vonë, mendoj që nuk janë shumë me prioritet mos të mbetemi shumë me atë çështje. Mendoj se janë tri probleme kryesore që na duhet t'i shohim në zbatim të ligjit: 1. a janë procedurat që janë parapa me këtë ligj dhe me ligjet e tjera për

investimet e jashtme në rregull dhe ku janë pengesat me licenca me regjistrim dhe me të gjitha. Nuk është problem regjistrimi i një biznesi, te ne është shumë i shpejtë, edhe nganjëherë mendoj që është tepër i shpejtë pa identifikuar mirë identitetin e investitorit, njerëzit mund të regjistrojnë biznes e mandej me bërë evazion fiskal e gjithçka tjetër. Kjo nuk është ftesë m' u kthye në procedura burokratike por identiteti i njerëzve që e formojnë biznesin, duhet me u ditur shumë mirë. Problemi është kur shkojnë me i marrë lejet dhe licencat në ministri dhe komuna, me këtë duhet të merremi shumë, ankesat e investitorëve janë në këtë sektor, sepse lejet te ministrinë dhe te komunat janë të ndërlidhura me vonesa me burokratizëm, ndoshta edhe me keqpërdorime e korrupsion. Mendoj se një nga konkluzat tona duhet të jetë që të shqyrtohet në tërësi problemi i efijencës së lejeve mu për këtë edhe u diskutua kjo që thamë. Unë po them që One Stop Shop apo zyra e veprimeve të shpejta duhet të ndihmojë të facilitojë edhe licencat, jo m'i kapërcye ligji. Njeriu vjen në një sportel dhe sa ma shumë sportele mundësia për kushtëzime edhe korrupsion është më e madhe.

2. Konkurrenca e barabartë, ajo që i brengos investitorët pos këtyre procedurave burokratike është konkurrenca fer në tregun tonë, a është fer apo nuk është, a është fer në mes aktorëve në treg dhe a është fer në prokurimet publike? Ky është problemi kryesor tjetër që nuk lidhet me ligj as nuk lidhet me këtë ministri. 3. Tjetër është mjedisi, në këtë rast e falënderojë edhe grupin punues që ka bërë një aktivitet shumë të mirë, edhe ministren sot që po jep kontributin e saj në këtë debat, por në faqen 12 (dymbëdhjetë) na i kemi problemet që janë të mjedisit biznesor. Mjedisi natyrisht që duhet përmirësohet por kërkon pak kohë. Te rekomandimet janë problemet këtu që i thamë, ajo që ne kërkojmë për KIESA-n, është që ne kërkojmë nga Ministria që sa ma shpejt atë gjendje të trashëguar ta tejkalojë edhe ta bëjë operative edhe funksionale KIESA-n. Sigurisht që për një muaj nuk munden me u evituar problemet, por unë besoj që këto masa janë duke u marrë, për drejtor u mbyll konkursi, u krye procedura, mirëpo tash duhet të shihet KIESA në tërësi, m'i pa përvojat, me bërë një studim të arsyeshmërisë si duhet të funksionojë KIESA, ku duhet të jetë më mirë. Unë nuk kisha qenë këtu shumë preciz që KIESA të zhvendoset në zyrën e Kryeministrit, por të kemi një studim të arsyeshmërisë se ku do të vendoset. Siç u theksua në ZKM ka shumë agjenci, duhet një riorganizim. Ne nuk duhet me hy në mikromenaxhment të ministrive, as mikromenaxhment të ZKM-së. Ne mund t'i japim sugjerime ata le t'i marrin në konsiderim edhe le të shohin qysh munden me na sjellë më shumë rezultate qytetarëve të Kosovës dhe Kuvendit të Kosovës, ajo është esenciale. Te KIESA nuk kisha dashtë që na të hyjmë në raste individuale të ankesave, nuk është rol as i Komisionit, as i Kuvendit, na po kërkojmë prej ministrisë të merret me KIESA-n ta aftësojë ta konsolidojë dhe ta bëjë aktive në interes të promovimit të investimeve. Çështja shumë e rëndësishme që ka bërë grupi punues është çështja e investimeve strategjike, dhe mendoj që kjo duhet të mbetet kështu pa marrë parasysh a nxjerrët ligj i veçantë apo amendamentohet ky ligj është çështje tjetër. Mirëpo kjo konkluzë ka ardhur si direkt duhet m'u arsyetuar me një apo dy paragraf, e mandej me ardhur si rekomandim, sepse e kemi vetëm te rekomandimet e nuk e kemi te përmbajtja e raportit. Kanë mundësi rekomandimet m'u sistematizuar, tjetër edhe në fillim të raportit keni vendosur një pyetësor shumë të gjerë, nuk di a duhet me lënë pasi nuk janë dhënë përgjigjet në raport.

Besim Beqaj – Tha se që në fillim e theksova që gjeturat që një raport duhet t'i bëjë janë të gjeturat nga komunikimi me biznese, atyre askush nuk mundet me ja mbyll gojën mos flisni në këtë fushë, por flisni në atë fushë. Të gjeturat janë ato të cilat na i kemi në raport dhe të cilat janë ndarë në dy segmente: segmentet administrative procedurale për institucionet dhe janë të gjeturat të cilat kanë të bëjnë me mjedis dhe kanë të bëjnë me politika ekonomike. Pra, mbi këtë bazë raporti i i tillë i përmban fillimisht të gjeturat dhe pastaj shkon duke i zbërthyer ato dhe duke krijuar rekomandime. Pra a do t'i themi Kuvendit në raport se 80% e debatit ka shkuar për komunikimet me funksionalitetin e KIESA-s e neve tash me na del diçka tjetër në Kuvend, unë atë nuk e bëjë. Pra komunikimi i cili është bërë me biznesin është komunikim i cili ka theksuar këto probleme. Politikat dhe hapat të cilat po merren për politikat fiskale është konstatuar nga bizneset se kanë ma tepër karakter social sesa karakter të mirëfilltë zhvillimor. Ne duhet ta

plotësojmë raportin me konkludimet edhe të ministres, ne për sistemimin dhe gjërat që kanë thënë bizneset do t'i theksojmë në raport, ndërsa sa i përket pjesës për investimet strategjike është thënë tërthorazi është më shumë bindje e jona e përgjithshme ndoshta do të hiqet krejt prej raportit, sepse nuk ka qenë ndonjë kërkesë shumë e madhe e komunitetit të biznesit. Mendimet e grupit punues do t'i shqyrtojmë edhe njëherë dhe kur të kemi në rend dite përsëri raportin do ju ofrojmë edhe rekomandimet.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Konkluzion

Raporti më Rekomandime lidhur më mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja duhet të rishikohet të risistematizohet në bazë të gjeturave dhe diskutimit të sotëm dhe të vjen edhe njëherë për aprovim.

4. Nisma legjislative për hartimin e Projektligjit për sigurinë në punë në miniera, e propozuar nga deputetja Sala Berisha - Shala

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, lidhur me këtë pikë, tha se në Planin e punës së Komisionit është paraparë nisma legjislative për Projektligjin për sigurinë në punë në miniera, të cilën nisme e ka propozuar deputetja znj. Sala Berisha – Shala. Pastaj ia kaloi fjalën për të paraqitur Nismën legjislative për hartimin e Projektligjit për sigurinë në punë në miniera.

Sala Berisha-Shala- Mendon se kjo është një iniciativë e mirë që të mbulohet kjo fushë, më Projektligjin për sigurinë në punë në miniera. Gjatë hartimit do të merren si model dhe për bazë disa ligje tjera dhe rregullore që e rregullojnë këtë fushë. Kërkoi që të formohet grupi i punës ku përveç anëtareve të Komisionit të ftohën ekspert dhe përfaqësuesit të kësaj fushe si: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ekspertë të Trepçës, KEK-ut dhe Fakultetit të Gjeo – shkencave etj. Po ashtu dhe organizata INDEP nga shoqëria civile që po e mbështet punën e Komisionit ka bërë një hulumtim se si është rregulluar kjo fushë në shtetet e rajonit. Ajo theksoi se në fund të hartimit të Projektligjit për sigurinë në punë në miniera duhet të organizojmë edhe dëgjim publik.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, kërkoi para së të fillohet më hartimin e projektligjit të shikohen ligjet e tjera të kësaj fushë, të mos të jone në kolizion njëra më tjetrën dhe bëhet një analizë e arsyshmerisë së cili është qëllimi i Projektligjit, të hartohet plani i veprimit të grupit të punës dhe mandej të sillet në Komision për miratim.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

V E N D I M

1. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri do të hartojë Projektligjin për Sigurinë në Punë në Miniera, i propozuar nga deputetja Sala Berisha – Shala;
2. Themelohet grupi i punës në këtë përbërje: Sala Berisha – Shala kryesuese, Raif Qela dhe Enver Hoti, si bartës i procesit të hartimit të Projektligjit;
3. Grupi i punës do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, si dhe mekanizmat tjerë për hartimin e këtij Projektligji;
4. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij;

5. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, do të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.
6. Shpenzimet për punën e grupit të punës për zbatimin e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Komisionit, respektivisht nga buxheti i Kuvendit.

4. Të ndryshme.

Visar Ymeri i njoftoi anëtarët e Komisionit se vizita e paraparë në KEK është anuluar për shkak se nuk ishte përbërja e plotë grupit të propozuar dhe kërkoi që kjo vizitë të realizohet gjatë javës së ardhshme.

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa propozoi që të shkojnë një grup i anëtarëve të Komisionit me këtë përbërje: Visar Ymeri, zëvendëskryetar i parë i Komisionit, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Blerim Grainca dhe Enver Hoti – anëtarë, mirëpo mund t'i bashkohen edhe deputetët e tjerë.

Me propozimin u pajtuan anëtarët e Komisionit.

4. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa